

URDHËR
Nr. 163, datë 9.2.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të germës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, germa “c” e pikës 2 të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”; të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave z. Andi Proko, drejtor i Drejtorisë së Kompensimit dhe Monitorimit të Regjistrimit Fillestar, për sa vijon:

- Për të nënshkruar shkresat me karakter njohës dhe informues, dalëse të Drejtorisë së Përgjithshme pjesë e fushës së përgjegjësisë së Drejtorisë së Kompensimit dhe Monitorimit të Regjistrimit Fillestar që u drejtohen të tretëve (personat fizikë, persona juridike privat), si dhe ato të drejtuara strukturave të varësisë së ASHK-së, në lidhje me procesin e kompensimit, në zbatim të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, drejtori i Drejtorisë së Kompensimit dhe Monitorimit të Regjistrimit Fillestar, nëse e gjykon të nevojshme, mund t'i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”.

4. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Drejtorisë së Kompensimit dhe Monitorimit të Regjistrimit Fillestar, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Ngarkohet Drejtorja e Kompensimit dhe Monitorimit të Regjistrimit Fillestar dhe z. Andi Proko, dhe Sektori i Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli